



Abuzimi seksual online ndaj fëmijëve: Këshilla për mbrojtjen e fëmijëve të moshës 4-7 vjeç

Ndani çaste cilësore me fëmijët

Fëmijët e vegjël nuk duhet të luajnë me ekrane. Shmangni përdorimin e ekraneve dhe ofroni lojëra, lodra dhe aktivitete që ua stimulojnë të gjitha shqisat. Asnjëherë mos u jepni ekrane për t'i qetësuar! Nëse vendosni të lejoni ekranet: vendosni rregulla bazë për përdorimin e tyre. Mos e lini kurrë fëmijën vetëm kur pajisja është e lidhur me internet. Mënyra më e mirë për reagim në kohë është të luani bashkë me fëmijën online, në mënyrë që të ndani me të vlerat dhe pritshmëritë. Tregojuni edhe miqve rregullat që keni vendosur. Është gjithmonë më mirë kur bini dakord mbi disa rregulla bazë edhe me prindërit e shokëve të fëmijës suaj.

Bëhuni shembull

Mos kaloni shumë kohë para ekranit kur keni fëmijët afër. Respektoni privatësinë e fëmijëve tuaj dhe kërkojuni leje kur doni t'i fotografoni apo të ndani ndonjë foto të tyre. Kërkoni poashtu që edhe shkolla të marrë leje nga fëmija para se ta fotografojnë apo të ndajnë fotografitë. Kontrolloni cilësimet e privatësisë në rrjetet sociale dhe aplikacionet tuaja për të mbrojtur fotot dhe dijeni që fotografimi i fëmijëve kur janë të zhveshur përbën rrezik.

Mos harroni të përditësoni çdo pajisje dhe aplikacion dhe të rikontrolloni cilësimet e privatësisë. Përdorni mbulesë mbrojtëse për kamerën kur nuk e përdorni. Kërkoni edhe këshilla të tjera për prindërimin digjital në internet për t'u siguruar që fëmijët tuaj janë të mbrojtur.

Bisedoni me fëmijët dhe sigurohuni që ata të komunikojnë me ju

Shpjegoni fëmijëve nën 8 vjeç që janë shumë të vegjël për të përdorur ekrane kur janë vetëm, pasi ato mund të jenë të rrezikshme. Vendosni rregulla të qarta, për shembull, që gjithmonë duhet të kërkojnë leje përpara se të përdorin një ekran.

Ndërtoni besim të fëmijët, ashtu që ata t'ju drejtohen juve kur të kenë nevojë për ndihmë. Nëse ju tregojnë që kanë shkelur ndonjë rregull apo që dikush u ka bërë diçka të papëlqyeshme, qëndroni të qetë dhe ngushëllojini. Nëse fëmija mendon që do të zemëroheni, turpëroheni apo mërzhiteni, mund të mos e vendosin që të ndojë shqetësimet me ju. Fëmija duhet të ndjehet gjithmonë i sigurt për t'i rënë bilbilat magjik që t'ju thirrë kur të ketë nevojë për ndihmë.

Ndalo dhunën ndaj fëmijëve!

Shpjegoni rëndësinë e privatësisë

Tregoni fëmijëve që trupi dhe fotot e tyre i përkasin vetëm atyre. Ata kanë të drejtë t'i thonë jo një puthjeje, prekjeje apo fotografie. Mos e detyroni kurrë fëmijën të pranojë të bëjë foto. Shpjegoni gjithashtu që ata nuk duhet kurrë të fotografojnë pjesët intime dhe as të lejojnë që këtë ta bëjë dikush tjetër.

Sigurohuni që fëmijët respektojnë privatësinë e të tjerëve

Shpjegoni që ekranet mund të vjedhin fotot e tyre. Bëjuani të ditur fëmijëve që kur behet një foto, ajo mund të dërgohet kudo dhe ta shohin shumë njerëz, madje edhe të panjohur.

Ka njerëz që sillen si Shumëvetja nga përralla: ata vjedhin fotot e fëmijëve dhe mund të jenë shumë të këqinj. Shpjegojani fëmijës se përse mbuloni kamerën e ekranit.

Prandaj, është më mirë që fëmijët t'ju kërkojnë leje para se të lejojnë dikë tjetër t'i fotografojë. Mund tu ndihmoni të bëjnë një listë të njerëzve që kanë të drejtë t'i fotografojnë. Shfrytëzoni rastin që tu thoni: askush nuk duhet t'ju fotografojë lakuriq apo në pjesët intime të trupit.

Kërkoni më shumë informacione!

Aftësitë e fëmijës zhvillohen, dhe nevojat dhe shkathtësitë e tyre ndryshojnë varësisht nga pjekuria dhe karakteri. Mund të ketë edhe faktorë të tjerë (si ndjeshmëria, paaftësitë apo përvojat e veçanta të jetës) që ndikojnë mjaft në aftësinë e fëmijës për tu mbrojtur dhe për të kuptuar dhe shmangur rreziqet.

Këshilli i Evropës bashkëpunon me qeveri, organizata dhe kompani me qëllim që të shfrytëzohen në maksimum përfitimet që sjell teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK) për fëmijët, që të ulen rreziqet dhe të mësohen fëmijët se si të jenë të sigurt.

Për fëmijët adoleshentë

Rregulla e të brendshmeve – Kiko dhe Dora

Video dhe broshurë „Thuaja dikujt që i beson“

Video dhe broshurë „Pra, a është ky abuzim seksual?“

Fletushkë „Mëso më shumë mbi të drejtat e tua në mjedisin digjital“

Për të rriturit

„Prindërimi në epokën digjitale – Strategji për prindërim pozitiv me skenarë të ndryshëm“

Udhëzime për prindër për mbrojtjen online të fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual – „Prindërimi në epokën digjitale“

„Mbrojtja e fëmijëve online: 6 video të shkurtra nga Elizabet Milovidov“

„Dy klikime përpara dhe një klik pas. Raporti mbi fëmijët me aftësi të kufizuara në mjedisin digjital“

„Doracak për lexim dhe përdorim të sigurt të internetit“



Financuar nga
Bashkimi Evropian

